


Korçë

NENTORI

E PERMUAJSHMË LETRARE ARTISTIKE
SHOQËRORE POLITIKE

1/1984



NËNTORI

ORGANI I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE
DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

*Revistë e përmuajshme
letrare artistike
shoqërore politike*

NR. 1, VITI XXXI I BOTIMIT,
JANAR, 1984

PËRMBAJTJA :

PLENUM I KOMITETIT DREJTUES TË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE

Vendim mbi thirrjen e Kongresit të 3-të të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë	7
Nga punimet e plenumit	8
Shkrimtarë, artistë e lexues përshëndesin revistën «Nëntori» në 30-vjetorin e saj	
DREDITËRO AGOLLI : Gjithmonë i ri dhe i freskët	17
ALEKS BUDA : «Nëntorit» tonë — mirënjohje dhe urimet më të përzemërta!.....	18
ALEKS ÇAÇI : Urimi ynë	20
KUJTIM BUZA : E dashur dhe e afërt edhe për ne piktorët e skulptorët	20
STERJO SPASSE : Revistë me tradita	21
ÇESK ZADEJA : Bashkëbisedues e këshillues për ne	22
ZIJA XHOLI : Një përvjetor e festë e bukur.	23
VIKTOR GJIKA : «Shtëpia» e ngrohtë e çdo krijuesi	24
ADELINA BALASHI, TEODOR KEKO : Aty ku trokasim dhe na presin me dashuri	25
DEMIR KËRÇISHTA, SKËNDER KARAPICI : Ngjarje e shënuar jo vetëm për shkrimtarët dhe artistët	26
KRITIKA LETRARE ARTISTIKE	
STAVRI KRISTO : Romani ynë në rrugën e zhvillimit të pandërprerë	27
ISUF NELAJ : Poezi e kohës së madhe — «Frymëzime na dha koha e Partisë» — antologji me poezi të zgjedhura	43

FISNIK SINA : Dialog i ngrohtë i poetit me lexuesin — <i>Mbi vëllimin «Tokë e pagjumë» të H. Meçajt</i>	51
AUREL PLASARI : Përmbledhje me pjesë të zgjedhura të epikës sonë gojore në frëngjisht	59
● FADIL KRAJA : Krijues dhe studiues i palodhur — <i>Në 60-vjetorin e lindjes së Vehbi Balës</i>	68
VEHBI BALA : Pisha dhe stuhitë — Baca Bajram në shpellë të Dragobisë — Manush Alimani dhe Hauzdingu — Amani i shqiptarit, <i>vjersha</i>	73
PUBLICISTIKË	
KOLË JAKOVA : Përsëri nëpër Zadrinë	76
KRIJIME LETRARE	
XHEVAHIR SPAHIU : Foleja e shqipo-njës — Mesnatë dimërore — Kthimi i Deas në atdhe — Mësimi i madh — Një këngë dashurie për nananë — Kënga e krojeve të Krujës — Dy kohët e një metalurgu — Dëshira e fshehtë — Njolla — Gjerësi — Herët në agim... — Orgesi në pasqyrë — Thyeje këtë heshtje — Anija prej guri — Pashënie për poetin — Kënga të rritë njeriun — Në shkallët e pallatit — Harroje prillin — E dashur, <i>vjersha</i>	87
BARDHYL LONDO : Vajzë e vogël me jetë të madhe, <i>poemë</i>	98
ALBERT RAKIPI : Bekimi i nënës sime — Qyteti i nesërm i hodhi themelet — Mirupafshim — Për udhën e vendlindjes, <i>vjersha</i>	107
HAJRI ZOGANI : Vendi më i bukur, më i lumtur — <i>vjersha</i>	110
NDREKO RINO : Bijtë e vegjëlisë, <i>vjershë</i> .	112
KRISTAQ JORGO : Mbrëmje qershori, <i>vjershë</i>	114
QAMIL BUXHELI : Abeli, unë dhe Paganini, <i>novelë humoristike</i>	115
ARISTOTEL MICI : Esmeralda, <i>tregim</i>	154
ILIR ZHILLA : Përllati, <i>tregim</i>	160
PROBLEME TEORIKE	
ILIA LËNGU : Itinerari revizionist i Lui Aragonit	169
STUDIME FOLKLORIKE	
RAMADAN SOKOLI : Lahuta dhe këngët e kreshnikëve	186

LETËRSI E HUAJ

NASHO JORGAQI : Përkthyesi krijues	206
<i>Nga poezia klasike franceze</i>	
ALFONS DË LAMARTIN: Liqeni <i>vjershë</i>	211
VIKTOR HYGO : Gjyqi i revolucionit, <i>vjershë</i>	213
FELIZ ARVER : Sonet	214
ZHERAR DË NERVAL : Një udhëzë e Lyksanburgut, <i>vjersha</i>	215
ËZHEN POTJE: Nuk ditke gjë, pra, ti?, <i>vjersha</i>	215
GYSTAV NADO : Fati dhe Amuri, <i>vjershë</i>	217
LUIZË MISHËL : Revolucion, <i>vjershë</i>	218
EDUAR PAJERON : Vau, <i>vjershë</i>	219
LUI TIERSLEN : Trëndafilat e shfletuar, <i>vjershë</i>	220
ZHAN RISHPEN : Zemra e nënës, <i>vjershë</i>	220
ZHAN MOREAS : Nokturn, <i>vjershë</i>	222

RECENSIONE, LETËRSI-ART

IRENA DONO : Nga vëllimet me tregime të romani i parë	223
VANGJEL LEKA : Duke shfletuar albumin «Gjurmë të historisë kombëtare...» — <i>Përgatitur nga Fototeka e Shkodrës</i>	227
TAIP SULKO : Mirënjohja për njeriun e punës — <i>Mbi vëllimin «Faleminderit» të Bujar Xhaferrit</i>	230

Kopertina : Bujar Marika : Pllakat kush-tuar 30-vjetorit të revistës «Nëntori».

Kryeredaktor : Dalan Shaplo

Kolegjiumi i redaksisë: Eglantina Mandia, Fatmir Gjata, Jorgo Bullo, Odhise Paskali, Simon Gjoni, Sterjo Spasse, Viktor Gjika, Xhevahir Spahiu, Zef Gurakuqi (sekretar i kolegjiumit).

**MË 23 PRILL 1984
MBLIDHET KONGRESI I 3-të
I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE
DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË**

**VENDIM
MBI THIRRJEN E KONGRESIT TË 3-të
TË ZAKONSHËM TË LIDHJES
SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË**

**PLENUMI I KOMITETIT DREJTUES TË LIDHJES
SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE TË SHQI-
PËRISË, MBLEDHUR MË 13 JANAR 1984,**

VENDOSI:

**MË 23 PRILL 1984 TË THIRRET KONGRESI I
3-të I ZAKONSHËM I LIDHJES SË SHKRIMTARË-
VE DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISË NË TIRANË.**

**KONGRESI DO TË ZHVILLOJË PUNIMET ME
KËTË REND DITE:**

- 1. RAPORTI I KOMITETIT DREJTUES TË
LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE.**
- 2. RAPORT I KOMISIONIT TË REVIZIONIMIT.**
- 3. DISKUTIME.**
- 4. ZGJEDHJET E REJA NË FORUMET E ORGA-
NIZATËS SË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE
ARTISTËVE.**
- 5. MIRATIMI I DOKUMENTEVE TË KONGRESIT.**

PLENUMI I KOMITETIT DREJTUES TË LSHA

Tiranë, më 13.I.1984

Nga punimet e plenumit të Komitetit Drejtues

Plenumi i Komitetit Drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, që u mbledh më 13 janar, diskutoi për arritje dhe probleme të vitit letrar artistik që kaloi dhe për veprimtari që do të zhvillohen gjatë vitit jubilar të 40-vjetorit të Çlirimit.

Veç anëtarëve të Komitetit Drejtues, merrnin pjesë të ftuar personalitete të letërsisë, artit dhe kulturës, kryetarë të degëve të Lidhjes në rrethe, punonjës të institucioneve artistike e kulturore, të shtypit letrar, të shtëpive botuese etj.

Gjithashtu merrte pjesë kandidati i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë dhe sekretar i parë i Komitetit të Partisë të rrethit të Tiranës shoku Foto Çami, kandidati i Komitetit Qendror të Partisë Anastas Kondo, Kryetari i Komitetit të Kulturës dhe të Arteve Sefedin Çela.

Plenumin e hapi kryetari i Lidhjes Dritëro Agolli. Pastaj u mbajtën dy referate nga sekretarët e Lidhjes Llazar Siliqi dhe Kujtim Buza. Si në referatet, ashtu edhe në diskutimet që u bënë pas tyre, u fol për punën e bërë gjatë vitit 1983 në zbatim të mëtejshëm të mësimëve të Partisë dhe të shokut Enver Hoxha për letërsinë dhe artet. Gjithashtu u theksuan edhe detyrat e shumta që dalin para krijuesve tanë për të përballuar me sukses të plotë e cilësi të lartë veprimtaritë letrare-artistike të vitit 1984.

Plenumi vendosi që Kongresi i 3-të i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë të fillojë punimet më 23 prill të këtij viti në Tiranë.

Në fund foli edhe shoku Dritëro Agolli. Ai vuri në dukje arritje dhe probleme të krijimtarisë letrare-artistike si dhe theksoi detyrat që dalin për zhvillimin me sukses të punimeve të Kongresit.

Në referatin e tij shoku Llazar Siliqi u ndal sidomos në panoramën letrare-artistike të vitit që shkoi. Drejtimit kryesor të veprimtarisë së Lidhjes, gjatë vitit 1983, të përcaktuara nga kryesia e saj, tha ai midis të

tjerash, janë vënë në jetë në mënyrë të kënaqshme. Këto drejtime rridhnin nga zbërthimi shkencor që u bëri plenumi i Lidhjes i marsit të vitit 1982 ideve, porosive dhe detyrave që vuri para gjithë krijuesve tanë Kongresi i 8-të historik i Partisë.

Vitin që shkoi muaji tradicional i letërsisë dhe i arteve koicidoi edhe me festimin popullor të 75-vjetorit të lindjes së udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit shokut Enver Hoxha, që ka dhënë e jep një ndihmesë të shquar edhe në mbrojtjen dhe zhvillimin e estetikës marksiste-leniniste. Kurse festa tjetër tradicionale, dita e poezisë, u organizua në mje-diset e Kombinatit të Autotraktorëve «Enver Hoxha» në Tiranë. Gjithashtu për herë të parë u organizua edhe dita e letërsisë për fëmijë që do t'u shtohet tani festave tona letrare-artistike.

Gjatë vitit 1983, tha më poshtë referuesi, qarkulluan 12 romane. Krahas autorëve të tillë me përvojë, si: S. Spasse, J. Dini, A. Gjakova, botuan romanet e tyre edhe autorë më të rinj si D. Çuli, N. Tozaj, M. Qilleri, B. Muço etj. Edhe për prozën e shkurtër mund të themi të njëjtat fjalë. 6 përmbledhjet me tregime e novela të T. Laços, N. Lerës, N. Priftit etj., e kanë pasuruar prozën tonë me tema të reja dhe forma bashkëkohore. Në të njëjtën kohë para prozës sonë mbetet detyrë rrokja sa më e gjerë e jetës dhe forcimi i realizmit, duke mënjanuar skematizmin dhe zbehtësinë e pasqyrimin të njeriut të ditëve tona. Në fushën e poezisë tërhoqën vëmendjen e lexuesve vëllimet poetike të H. Meçajt, N. Kacalidhës, Bujar Xhaferit, V. Skënderit, T. Kekos si dhe të poeteshave Xh. Jorganxhi, E. Ballauri e A. Balashi. Në konkursin letrar-artistik të shpallur për 40-vjetorin e Çlirimit të atdheut do të paraqiten vepra të mira si në roman, ashtu edhe në poemën tonë, që ka tradita aq të njohura. Për sa i përket dramaturgisë, me gjithë përpjekjet, niveli cilësor i veprave të vëna në skenë nuk i përgjigjet sa duhet kohës. Më shumë kërkohet edhe nga kritikët.

Pastaj referuesi u ndal në disa arritje të kinematografisë artistike dhe dokumentare. Gjatë vitit 1983 u shfaqën disa filma me vlera të shquara ideo-artistike si: «Enver Hoxha, tungjatjeta» të autorëve V. Gjika e S. Dede, «Kujtime për Gjirokastrën» me skenar e regji të Dh. Anagnostit, «Gju më gju me popullin»

(film televiziv) me regjisor M. Shanaj, kurse filmi tjetër dokumentar «Shoku i mirë Gogo», i regjisores D. Muçi, u xhirua mbi skenarin e Sh. Musarajt dhe M. Skënderit. Nga filmat artistikë, megjithëse në prodhimin e tyre ka pasur një aritmi të pajustificueshme, mund të përmendim «Kohë e largët» (S. Pecani, S. Andoni), «Një emër midis njerëzve» (M. Fejzo, N. Lako) dhe «Dritat e qytezës» (F. Hoshafi, S. Godo).

Edhe artet figurative, vazhdoi më poshtë referuesi, gjatë vitit 1983 shënuan arritje të reja. Piktorët, pasi shkuan nëpër kantiere e vepra të pesëvjeçarit, hapën rreth 20 ekspozita vetjake nga të cilat mund të përmendim ato të N. Jonuzit, S. Roçit, Y. Harunit e K. Koprenckës, të N. Ivanajt apo M. Tannellarit. Me interes të veçantë u ndoqën punimet në qeramikë të piktorit të popullit S. Shijaku paraqitur në ekspozitën «Epika legjendare».

Nga veprimtaritë muzikore mund të përmendim Koncertet e Majit për të cilat u shkruan dhe u ekzekutuan rreth 250 vepra muzikore e koreografike, Koncertet e Nëntorit, që kanë nisur të organizohen në Durrës dhe në Korçë, festivalet kombëtare e lokale që organizohen çdo vit etj. Për këngën mbetet aktuale çështja e krijimit të këngëve të këndueshme. Problemet që i dalin muzikës sonë kërkojnë edhe një gjallërim të mëtejshëm të mendimit kritik. Këtij qëllimi i shërbeu aktivi i organizuar nga sektori përkatës mbi gjendjen dhe problemet e kritikës muzikore, që pati një nivel të kënaqshëm.

Pasi foli për ndihmesën që dhanë shkrimtarët dhe artistët në veprimtari të tilla të rëndësishme kombëtare si: Festivali Folklorik Kombëtar apo simpoziumi «Epika heroike shqiptare», Ll. Siliqi u ndal disa probleme organizative të Lidhjes dhe në punën e organeve të saj të shtypit, «Drita», «Nëntori» dhe «Les lettres albanaises», duke theksuar arritjet, por edhe problemet e detyra që u dalin.

Në referatin e tij shoku Kujtim Buza foli veçanërisht për detyrat që u dalin krijuesve për të përballuar me sukses veprimtaritë e shumta e të larmishme në vitin jubilar të 40-vjetorit të Çlirimit.

Kongresi ynë i 3-të, tha midis të tjerash ai, do të mblidhet kur numri i shkrimtarëve dhe artistëve është trefishuar nga koha kur u mbajt Kongresi i 2-të. Shoku Enver në fjalën e tij në pritjen e dhënë me rastin

e mbylljes së punimeve të Kongresit të 2-të të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë më 26 prill 1969 tha: «S'ka dyshim se, kur të mblidhemi në Kongresin tuaj të 3-të, do të jeni aq shumë, sa do t'ju duhet një sallë shumë e madhe. Përgatitjes, shtimit, rritjes dhe edukimit të shkrimtarëve dhe artistëve Partia u kushton vëmendje të madhe».

Tashmë shkrimtarët dhe artistët janë bërë një armatë e madhe që me veprën e tyre kanë ndihmuar në edukimin e njeriut tonë të ri me idealet e shoqërisë socialiste. Konkursi i madh kombëtar letraro-artistik kushtuar 40-vjetorit të Çlirimit të atdheut është një ngjarje e madhe për jetën tonë letrare dhe artistike, një ndër aksionet tona më të rëndësishme të këtij viti jubilar.

Kongresin tonë të 3-të duhet ta presim me vepra të një niveli sa më të lartë ideoartistik, duke rritur cilësinë e krijimtarisë, trajtimin veçanërisht të temës së aktualitetit tonë socialist, duke njohur historinë, jetën dhe psikologjinë e njeriut tonë, duke pasqyruar momente kyçe të jetës dhe veprimtarisë së tyre.

Duke folur për veprimtaritë muzikore shoku K. Buza vuri në dukje se Koncertet e Majit që po na afrojnë, takimet kombëtare të këngëtarëve, të instrumentistëve, të grupeve amatore të klasës punëtore, festivalet e këngës popullore të përpunuar dhe ai për fatosa e pionierë, koncertet e mëdha që do të jepen në kuadrin e 40-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe të tjera — janë aksione të rëndësishme të këtij viti që duhet të përgatiten me nivel të lartë cilësor.

Më poshtë ai foli për disa vepra muzikore që janë në proces të realizimit dhe shprehu besimin se do të kryhen me sukses dhe do të shënojnë arritje të reja të muzikës sonë skenike.

Në vazhdim referuesi tha se do të zhvillohet Takimi Kombëtar i teatrove profesioniste, Java e teatrit profesionist dhe amator në Tiranë e në Korçë. Kinostudioja «Shqipëria e re», kolektivi i saj dhe bashkëpunëtorët e filmit, do të paraqesin gjatë këtij viti 14 filma artistikë, 40 kinoditarë dhe 16 filma vizatimorë.

Duke u ndalur në fushën e arteve figurative shoku K. Buza theksoi se aktivitetet që do të organizohen gjatë këtij viti do të shënojnë arritje të reja edhe më të mëdha. Ekspozita kombëtare e arteve figurative kushtuar 40-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe para

saj gjithë ekspozitat lokale që do të hapen me këtë rast, do të jenë ngjarje të shënuara në jubileun e çlirimit. Skulptori Sh. Hadëri ka përfunduar «Monumentin e Heronjve të Vigut» dhe shtatoren e «Isa Boletinit» që do të ngrihen në qytetin e Shkodrës; K. Rama, M. Dhrami, Sh. Hadëri e Th. Dharmo po punojnë për variantin përfundimtar në skicë-ide të monumentit të lirisë; H. Dule dhe F. Dushku për monumentin e Rezistencës së 7 prillit në Durrës; P. Çuli për monumentin e Reformës Agrare dhe të kolektivizimit të Bujqësisë në Lushnjë; K. Rama për shtatoren e Avni Rustemit; piktori Z. Shoshi ka përfunduar tablone kompozicionale «Mbledhja e Moskës»; V. Kilica po punon mbi kompozimin kushtuar «Shpalljes së Republikës»; A. Faja mbi tablone «Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945»; H. Nallbani dhe S. Shijaku do të kenë ekspozitat e tyre vetjake, ndërsa piktorët P. Mele dhe P. Kokushta tablo me temën e klasës punëtore.

Kurse në fushën e letërsisë, tha referuesi, gjatë këtij viti janë planifikuar të futen në shtyp 150 tituj. Nga këta 17 romane, 20 vëllime me tregime dhe novela, 40 tituj me poezi, dramë dhe kritikë, 52 tituj në fushën e letërsisë për fëmijë. Gjatë kësaj kohe do të dalin vëllimet në seri të F. Gjatës dhe të A. Abdihoxhës. Do të botohen gjithashtu 16 tituj nga letërsia e huaj përparimtare.

Pas referatit të dytë u bënë diskutimet. I pari e mori fjalën shkrimtari Fatmir Gjata, i cili, veç të tjerave, nëpërmjet disa kujtimeve të tij, foli për zhvillimin sasior dhe cilësor të letërsisë dhe arteve në 40 vjetët e lirisë së vërtetë që na sollti Partia. Ndërsa Feim Ibrahim, sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, u përqendrua kryesisht te veprimtaritë muzikore të vitit që kaloi dhe tek ato që i presin krijuesit tanë. Poeti Xhevahir Spahiu, duke u ndalur sidomos te trajtimi i temës së klasës punëtore në letërsinë tonë, theksoi domosdoshmërinë e thellimit të pasqyrimit të kësaj teme qendrore për një letërsi të realizmit socialist, siç është ajo e jona. Kryeredaktori i gazetës «Drita» Zija Çela foli për rëndësinë e shtypit në pasqyrimin e stadi aktual të zhvillimit të letërsisë dhe arteve tona, si dhe për masat që janë marrë për t'i pasqyruar sa më mirë veprimtaritë në vitin jubilar

para dhe pas kongresit të Lidhjes. Shkrimtari Hasan Petrela diskutoi për funksionimin e degëve të Lidhjes, për arritje dhe probleme që dalin lidhur me to, kurse shkrimtari Teodor Laço për nevojën e trajtimit të temës së aktualitetit socialist dhe për rritjen e nivelit cilësor në letërsi.

Pastaj e mori fjalën kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve Dritëro Agolli, i cili, ndër të tjera, tha: Një vit letrar dhe artistik kaloi me arritje dhe me dobësitë e tij. Tani jemi para një viti tjetër të ngarkuar me ngjarje, veprimtari dhe aksione letrare e artistike. Është viti i 40-vjetorit të Çlirimit të atdheut e të fitores së revolucionit. Një ndër aksionet më të mëdha që kanë letërsia dhe artet në këtë vit është Kongresi i 3-të i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, kongres që do të bëjë bilancin e arritjeve gjatë këtyre pesëmbëdhjetë vjetëve pas kongresit tonë të 2-të dhe do të caktojë detyrat dhe objektivat për të ardhmen nën drejtësinë e vendimeve të Kongresit të 8-të të Partisë. Siç u tha edhe nga referatet e shokëve Llazar Siliqi e Kujtim Buza, edhe në diskutimet e pjesëmarrësve në këtë plenum, problemet që do të shtrohen në kongres duhet të rrihen e të diskutohen mes shkrimtarëve dhe artistëve gjerësisht: në takime dhe në shtypin letrar; të nxirren në pah arritjet dhe të gjenden rrugë për mënjanimin e të metave si në krijimtarinë letrare e artistike, ashtu edhe në veprimtarinë drejtuese të Lidhjes. Të vështrohet organizata jonë krijuese si një organizëm i gjallë e frymëzues dhe jo si një mekanizëm i ngurtë dhe burokratik.

Gjatë vitit që shkoi ka pasur disa arritje që tregojnë se shkrimtarët dhe artistët janë shqetësuar seriozisht për ngritjen e nivelit artistik të krijimtarisë së tyre. Arritjet cilësore kanë qenë më të dalluara në lëmin e tregimit e të filmit, të muzikës dhe të arteve figurative.

Në lëmin e romanit, pas fundit të viteve 70-të, nuk kanë dalë libra me peshë. Gjithashtu edhe poema pothuajse ka mbetur e palëvruar. Kjo gjendje duhet të na bëjë të mendohemi edhe si shkrimtarë dhe artistë, edhe si redaktorë apo drejtues të krijimtarisë. Idetë, mendimet dhe temat për vepra të mëdha shterojnë, në qoftë se nuk ndiqet jeta, në qoftë se nuk jetojmë intensivisht me problemet e shoqërisë dhe me situatat e brendshme dhe të jashtme të vendit. Pra-

ndaj është e domosdoshme të revolucionarizojmë më tej mënyrën e jetesës sonë artistike, ta kërkojmë më shumë jetën e njerëzve, shqetësimet dhe hallet e tyre.

Për poezinë nuk mund të flasim si për romanin. Dhe kjo e ka burimin në kërkimet e pakta, në përsëritjen e atyre përmbajtjeve dhe formave të zbuluara me kohë. Poeti është zëri i epokës. Ai duhet t'i thotë me këtë zë diçka të re shoqërisë. Pa ia thënë këtë shoqërisë, zëri i poetit nuk dëgjohet, pasi shkrihet dhe humb mes zërave të tjerë të zakonshëm. Prandaj poezia përherë kërkon ripërtëritje të instrumenteve poetike dhe të mendimit. Jeta jonë e favorizon poezinë. Në 40-vjetorin e Çlirimit poetët kanë se ç'të thonë në poema e në vjersha. Gjithë këto transformime në shoqëri e në jetën individuale të njerëzve e gjithë ky revolucion janë objekt i madh për poezinë.

Ndryshe poezisë, kohët e fundit, tregimi, pas rënieve të përkohshme ka pasur ngritje dhe rimëkëmbje. Dhe, megjithatë, kërkohet që në tregim të hyjë më shumë jeta e sotme e shoqërisë, të pasqyrohet më i plotë njeriu, puna dhe morali i tij jashtë skemave të standardizuara. Skemat ndihen më shumë në tregimin që botojnë gazetat dhe revistat, që në përgjithësi janë tregime me konflikte artificiale, të trilluara dhe pa jetë. Ato zënë vendin e reportazheve të zbeh-ta fjalëshumë. Dhe me që ra fjala për reportazhin, është e udhës të themi se ai është kthyer disa herë në një deklaratë bombastike pa mendim, pa informacion, pa ngjarje dhe pa jetë.

Në pikturë dhe në përgjithësi në artet figurative ne mund të kemi vërejtje tek-tuk për cilësinë. Por një nga arritjet më të mëdha të këtyre arteve, që u vu re edhe në vitin 1983, është përpjekja e piktorëve për të futur në veprat e tyre sa më shumë jetë. Megjithatë, për pikturën dhe skulpturën niveli artistik mbetet një problem aktual, si për gjithë artet.

Arritje në muzikën tonë gjatë vitit 1983 ka pasur, dhe krijimtaria e kësaj fushe është në rrugë të drejtë. Por mendojmë se kjo nuk duhet të priret vetëm ndaj gjinive të lehta, si kënga dhe vallja e përpunuar folklorike dhe vetëm drejt manifestimeve muzikore të organizuara në data të caktuara. Është e domosdoshme që t'u kushtohet vëmendje më shumë gjinive të muzikës skenike, simfonike e të tjera, përndryshe nuk do të kemi një zhvillim harmonik.

Krahas letërsisë, arteve figurative dhe muzikës kanë ecur edhe filmi dhe teatri. Në këto fusha ka pasur përpjekje serioze për të ngritur nivelin artistik të krijimtarisë, veçanërisht në veprat me temën aktuale.

Edhe për filmin, edhe për dramaturgjinë mbetet si problem zgjerimi i gamës së tematikës, në mënyrë që në ekran dhe në skenë të hyjë më e plotë jeta e shoqërisë sonë dhe të pasqyrohet më me vërtetësi artistike ndërtuesi i socializmit. E theksojmë këtë pasi me gjithë arritjet, ende, sidomos në dramë, jeta pasqyrohet e zbehtë, me konflikte të trilluara dhe artificiale. Dramat kanë pak mendim dhe herë-herë u mungon vërtetësia. Njeriu në to shpesh është i skematizuar dhe i larguar nga njerëzit e vërtetë të jetës. Hapi drejt ngritjes së nivelit artistik duhet të kalojë përmes luftës kundër skematizmit, shabllonizmit dhe vulgarizmit.

Për 40-vjetorin e Çlirimit duhet të bëjmë çmos që të kemi, përveç të tjerave, një film artistik të fuqishëm, të denjë për këtë jubile, ku të tregohet shpirti revolucionarizues i komunistëve, të kemi gjithashtu nga një dramë në çdo teatër profesionist të Republikës me këtë temë.

Më poshtë shoku Dritëro Agolli theksoi se Kongresi i 3-të i organizatës sonë krijuese do të jetë një ngjarje e madhe për letërsinë dhe artet dhe në përgjithësi për kulturën tonë.

Kongresi ynë mbahet në vitin e 40-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor. Përgatitjet për kongres duhet të shoqërohen, në radhë të parë, me krijimtari të re letrare e artistike, por edhe me diskutime, debate dhe rrahje mendimesh për letërsinë dhe artin. Punë intensive ka edhe shtypi letrar, «Drita» dhe «Nëntori». Me shkrimet e tij ai duhet të krijojë një atmosferë optimiste dhe pune krijuese, të ndezë fantazinë me rubrika të reja dhe të botojë artikuj, reportazhe, intervista, tregime dhe vjersha me mendime të pasura dhe emocione të thella.

Viti 1984 është plot veprimtari në të gjitha fushat e jetës. Letërsia dhe artet kanë pjesën e tyre të rëndësishme. Pas kongresit të Lidhjes, menjëherë fillojnë Koncertet e Majit, kemi përpara konkursin e madh letrar artistik, ekspozitën kombëtare të arteve figurative, olimpiadën teatrale që do të hapet në nëntor dhe veprimtari të tjera të rëndësishme.

Që të kurorëzohen me sukses këto aksione kulturore e artistike, nuk mjafton vetëm puna krijuese e shkrimtarëve dhe artistëve, por është e nevojshme që vetë Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, shtëpia botuese «Naim Frashëri», kinostudioja «Shqipëria e Re», Radiotelevizioni, Teatri i Operës dhe Baletit, Teatri Popullor dhe teatrot e tjerë në rrethe të qëndrojnë në krye të veprimtarisë, të bashkëpunojnë në ndjekjen e krijimtarisë letrare e artistike dhe të shqetësohen vazhdimisht, ashtu siç porositi edhe Plenumi i 8-të i KQ të Partisë në dhjetorin e vitit të kaluar.

Partia ka besim të plotë se shkrimtarët dhe artistët, të brumosur me idetë e saj dritëdhënëse dhe me mësimet e shokut Enver, do t'i ngjitin letërsinë dhe artet në një stad të ri dhe kështu do ta pasurojnë më tej kulturën tonë kombëtare socialiste.

Korresp. i «Nëntorit»

Shkrimtarë, artistë e lexues

përshëndesin

revistën «Nëntori»

në 30-vjetorin e saj

GJITHMONË I RI DHE I FRESKËT

Ka tridhjetë vjet që «Nëntori» ka hyrë në jetën letrare e artistike të vendit dhe është bërë një tribunë e vërtetë e shkrimtarëve dhe e artistëve, tribunë e krijimtarisë dhe e mendimit të tyre. Shumë vepra që sot kanë zënë vend në fondin e artë letrar, në fillim janë botuar në faqet e «Nëntorit». Gjithë shkrimtarët e «brezit të mesëm» dhe ata më të rinjtë, tregimet, vargjet apo romanet e para i kanë përcjellë te lexuesit përmes kësaj tribune. Prandaj themi se ne jemi rritur bashkë me «Nëntorin». Në faqet e tij kemi ndier gëzimin e shkrimeve të para, kemi ndier erën e bojës së freskët të shtypshkronjës, që vetëm ne që merremi me shtypin e dimë sesa e dashur është!

«Nëntori» në këta tridhjetë vjet ka luftuar për përparimin e letërsisë dhe të arteve, për pasurimin e përmbajtjes dhe të formës së tyre, për mbrojtjen e parimeve të metodës së realizmit socialist dhe për rritjen e frymës militante të krijimtarisë. Duke vënë në jetë orientimet e Partisë dhe mësimet e shokut Enver, «Nëntori» ka kërkuar një letërsi dhe një art të lidhur ngushtë me jetën e popullit dhe me proble-

met e shoqërisë socialiste. Letërsia dhe arti pasqyrojnë raportet e njerëzve në shoqëri. Këtë ka kërkuar edhe «Nëntori» si tribunë e fjalës së shkrimtarit dhe artistit.

Tani që hyri në dhjetëvjeçarin e katërt të tij ai lufton që letërsia dhe artet të vënë në jetë vendimet e Kongresit të 8-të të Partisë për ngritjen e nivelit ideor e artistik, për pasurimin e problematikës dhe për plotësimin e tablosë së epokës së madhe të socializmit me tema të reja dhe heronj të rinj. Me luftën për ecjen përpara të letërsisë dhe të arteve, me kërkimet e përhershme të së resë, «Nëntori» gjithmonë do të mbetet i freskët dhe i ri.

Antëro Agolli

«NËNTORIT» TONË – MIRËNJOHJE DHE URIMET MË TË PËRZEMËRTA!

Kam ende të freskët kujtimin e atyre viteve entuziaste — të parat pas Çlirimit, kur bënim hapat tanë të parë, të parë por të sigurt, siç e tregoi puna, në të gjitha fushat: kur filluan jetën shkollat tona të larta, institucionet e para kulturore dhe midis tyre shtypi ynë letrar-artistik. Populli i lirë kishte nevojë dhe etje për letërsinë, për artin, për kulturën e tij të re revolucionare, ashtu siç kishte nevojë për bukën e gojës. Sa modeste ishin ato fillime, por sa krenarë ishim ne atëherë — e me të drejtë! — kur dolën numrat e parë të «Literaturës sonë» e të pasardhësit të saj, të «Nëntorit» që mbush tani plot 30 vjet! Ato ishin në kuptimin e plotë «tonat» në frymë, në formë e përmbajtje, në aspirata.

Ishte kujdesi, dashuria me të cilën e ndoqi kurdoherë shoqëria jonë socialiste dhe Partia, populli i etuar për kulturë, punën e shkrimtarëve tanë revolucionarë që nga hapat e tyre të parë, të cilët e rri-

tën letërsinë tonë edhe bashkë me të «Nëntorin» në këto 30 vjet jete dhe pune të begatshme dhe të palodhur. Brezat e shkrimtarëve e bënë «Nëntorin» nga një filiz, një lis të fuqishëm. Shpjegim i kësaj rruge arritjesh është se «Nëntori» ynë u rrit bashkë me të renë në gjithë jetën tonë: ai e pasqyron atë me tematikën e tij, me nivelin artistik, me qartësinë e mendimit e më në fund edhe me numrin e faqeve edhe me aspektin estetik të paraqitjes së tij. «Nëntori» ka hapur për ne të gjithë një dritare të madhe drejt jetës së vërtetë të popullit tonë dhe përpiqet ta pasqyrojë atë më së miri me krijimet letrare-artistike, me artikujt, me studimet që boton. Ai është vazhdimisht në kërkim të formave të reja, të rubrikave interesante. Në faqet e tij ka gjetur vend ç'ka më të mirë letërsia përparimtare botërore.

Për të përhëndetur është — e them këtë sidomos si historian — që «Nëntori» i ka lënë vend lëvrimit të traditave tona kulturore, jo vetëm në letërsi e art, por edhe traditave të mëdha patriotike revolucionare në përgjithësi.

Nëse mund të shprehja një dëshirë — ndofta tepër subjektive — do të ishte kjo: që të mund të lexonim në faqet e «Nëntorit» edhe më shumë shkrime publicistike për probleme të ndryshme të jetës sonë e të zhvillimeve të saj të reja. Është kjo një gjini letrare e cila te ne nuk ka gjetur ende vend të mjaftueshëm në botimet tona periodike. Natyrisht, këtu nuk është fjala për studime siç i botojnë organet e specialitetit.

«Nëntori» e ka merituar plotësisht dashurinë e popullit dhe mirënjohjen e publikut lexues, vlerësimin e gjithë punonjësve në fushën e kulturës. Le t'i urojmë atij në 30-vjetorin e jetës dhe të punës që t'i çojë edhe më tej këto arritje, për të mirën e letërsisë dhe të artit tonë të realizmit socialist, për të mirën e kulturës sonë socialiste kombëtare! Punë të mbarë edhe më tej!

Aleks Buda

URIMI YNË

Tridhjetë vjet më parë lindi revista «Nëntori». Lindi në një tokë pjellore. Foshnje e re, tregoi që në fillim se do të rritej e shëndoshë. Ajo do të vazhonte rrugën e shtypit ilegal të Luftës Nacionalçlirimtare — stil i gjallë e konciz, ndjenja të thella të dashurisë për popullin, për atdheun dhe për idealet komuniste, urrejtje për çdo armik që do të pengonte ecjen përpara të popullit drejt përparimit dhe dritës, ndjenja të dashurisë për popujt e tjerë liridashës. Këtë rrugë revista e ndoqi me besnikëri dhe entuziazëm, e zgjeroi dhe shkrimet që botoi kanë qenë ushqim i pastër për lexuesin, për ta pajisur atë me virtytet më të mira të njeriut të ri, për ta fisnikëruar, siç thoshte Gorki.

Nga ana tjetër, revista, që në numrat e saj të parë, u bë një vatër e ngrohtë, ku u mblodhën të rinjtë që kishin etje për letërsi dhe që, gjatë këtyre viteve, ecën dhe u bënë të njohur në popull.

Dhe sot revista «Nëntori» kthen sytë prapa, shikon nga u nis, shohit punën që ka bërë, ka parasysh kërkesat e shumta të lexuesve dhe, me siguri, duke ndjekur si gjithnjë mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha, do ta ngrejë më lart cilësinë e shkrimeve, do të bëhet edhe më tepër ushqim i shëndetshëm i lexuesve. Ky është dhe urimi ynë.

Alex Cas

E DASHUR DHE E AFËRT EDHE PËR NE PIKTORËT E SKULPTORËT

Bashkë me koleksionin e gazetës «Drita» kemi në studio edhe 30 vjet revista «Nëntori» që, edhe pse në pamje janë vjetëruar nga koha, kanë mbetur të reja,

të dashura dhe të afërta edhe për ne artistët e artit figurativ, jo vetëm sepse aty lexojmë vlerat më të dalluara të letërsisë sonë dhe të huaj përparimtare dhe mësojmë për traditat tona të shquara në art, letërsi e kulturë, për probleme teorike të letërsisë dhe artit tonë të realizmit socialist, por edhe pse në të botohen studime, artikuj kritikë etj. edhe për artet figurative dhe gjejmë në çdo numër riprodhime pikturash dhe vizatime e fotografi që e bëjnë këtë organ më të plotë dhe më të bukur grafikisht. Bashkë me shkrimet e vazhdueshme, edhe ne piktorët gëzo-hemi dhe e ndiejmë gjithmonë të re këtë revistë të shquar letraro-artistike, organin tonë për të cilin kemi detyrime akoma më të mëdha.

Mujdun Bura

REVISTË ME TRADITA

Si një nga pjesëtarët e redaksisë e të kolegjiumit të kësaj reviste që nga fillimi e gjer në ditët tona, mua më ngazëllen së tepërmi ky jubile, që më kujton jetën e gjatë plot përpjekje dhe fitore të këtij organi. Në jetën tonë letraro-artistike kombëtare, që nga Rilindja e gjer më sot, ne nuk kemi revistë si kjo, revistë që krijoi traditën e saj duke pasur si pararendëse revistat «Bota e Re» dhe «Literatura jonë». Dhe tradita e kësaj reviste është gatuar me mësimet e mëdha të Partisë e të mësuesit tonë të dashur, shokut Enver Hoxha. Ajo është një *diagram* besnik i rritjes e i ngritjes së vijueshme të letërsisë e të arteve tona të realizmit socialist. Armiqtë e brendshëm u orvatën të depërtonin në faqet e saj me mendime dekadente, por Partia, që na ndriçon gjithnjë rrugën krijuese, i demaskoi e i goditi në Plenumin IV të Komitetit Qendror.

Për shkrimtarët e artistët tanë revista «Nëntori» u bë një shkollë e vërtetë, ku u propaganduan e u zbërthyen mësimet marksiste-leniniste të Partisë për zhvillimin e letërsisë dhe të arteve tona të realizmit socialist, ajo u bë një *nxitëse* për arritje të mëtejshme ideoartistike.

Duke filluar që nga plejada e shkrimtarëve dhe e artistëve më me stazh, si: Nonda Bulka, Shevqet Musaraj, Dhimitër Shuteriqi, Aleks Çaçi e Andrea Varfi, Odhise Paskali, Abdurrahim Buza me shokë e duke vazhduar me breza të tjerë, që vazhduan e vazhdojnë të vijnë njëri pas tjetrit me krijimet e tyre origjinale, ne të gjithë në faqet e kësaj reviste kemi jetuar «mallin e stampës», ankthet e ngazëllimet e krijimtarisë me botimin e veprave tona të gjinive të ndryshme. Këto ngazëllime na gjallëroheshin më parë nga vërejtjet e nga sugjerimet e redaksisë e të kolegjiut dhe vazhdonin, pas botimit në faqet e revistës, me sugjerimet e me vërejtjet e lexuesve. Ato na kanë vlejtur për t'u dhënë dorën e fundit veprave tona, para se t'ia dorëzonim Shtëpisë Botuese «Naim Frashëri», kanë qenë ndihmesë me vlerë për përmirësimin e krijimeve tona e për ngritjen e tyre cilësore.

Në këtë jubile faqebardhë i uroj revistës sonë që të forcohet më tej nga ana ideoartistike e që të pasurohet edhe më shumë nga ana cilësore e sasiore edhe në rubrikat e kritikës letraro-artistike, të reportazheve e të recensioneve.

Skënder Xhuvani

BASHKËBISEDUES E KËSHILLUES PËR NE

Si bashkëpunëtor i «Nëntorit», e ndiej shumë të afërt këtë përvjetor të revistës. Kjo edhe pse gjatë veprimtarisë sime si krijues kam gjetur te «Nëntori» një «bashkëbisedues» intim, një këshillues, pse aty janë rrahur mendime të pjekura, të cilat më kanë ndihmuar në krijimtari.

Kjo festë e revistës na shtyn që në të ardhmen ta shtojmë bashkëpunimin me të, për vepra konkrete të muzikës sonë si dhe për probleme teorike. Se edhe në muzikë, si në çdo fushë tjetër, mendimi teorik i

paraprin krijimtarisë. Dhe mendimi ynë është më i përparuari, sepse udhëhiqet nga ideologjia marksiste-leniniste e Partisë sonë dhe nga mësimet e çmuara të shokut Enver.

Do të dëshiroja që në të ardhmen këto shkrime për muzikën të jenë edhe më të shumta, ashtu siç është e gjerë dhe e larmishme muzika jonë e realizmit socialist. Ia shprehim këtë dëshirë «Nëntorit», që tashmë e kemi një revistë me personalitet të veçantë.

Çesk Zogjini

NJË PËRVJETOR E FESTË E BUKUR

30-vjetori i revistës «Nëntori» është një përvjetor dhe një festë e bukur — festë e shkrimtarëve dhe e artistëve, e lexuesve, e kulturës sonë të re socialiste.

Festë e shkrimtarëve dhe e artistëve! Çdo numër i revistës u jep gëzimin e botimit si shkrimtarëve më të mirë, ashtu dhe atyre që për herë të parë guxojnë të dalin para publikut lexues. Edhe nëpërmjet revistës «Nëntori», nga muaji në muaj, rritet e bëhet më i dendur me filiza të rinj pylli i letërsisë shqipe të realizmit socialist.

Festë e lexuesve! Çdo numër i revistës u jep mijëra lexuesve kënaqësinë estetike të njihen me krijimet më të mira të letërsisë dhe të arteve tona socialiste, i ndihmon të formohen dhe të edukohen si lexues që, duke u gëzuar për çdo sukses të tyre, nuk pajtohen me asgjë të zbehtë si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Festë e kulturës sonë të re socialiste! Revista ka marrë përsipër të jetë një e përmuajshme edhe shoqërore politike. Vëmë re se edhe këtë mision «Nëntori» e ka kryer më së miri. Në faqet e tij kanë parë dritën plot artikuj dhe studime me karakter historik, filozofik, diplomatik, moral. Kjo nuk mund veçse të përshëndetet nga publiku ynë i gjerë i etur për dituri e kulturë.

Emri «Nëntori» i revistës është programi i saj, një

program i gjerë dhe plot premtime: të mbrojtë, të zhvillojë dhe të përhapë me mjetet specifike të artit idetë e Nëntorit, porosinë e Partisë, mësimet e shokut Enver Hoxha, idetë e lirisë e të pavarësisë, të progresit socialist. Ky orientim ideor e ka bërë «Nëntorin» një revistë luftarake, revolucionare dhe të dashur nga të gjithë. Kjo është garancia më e sigurt që edhe në të ardhmen revista të jetojë plot shëndet dhe të mbetet gjithnjë e re, çka i urojmë me gjithë zemër në këtë 30-vjetor të saj.

Ejja Shkri!

«SHTËPIA» E NGROHTË E ÇDO KRIJUESI

Duke qenë organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, revista «Nëntori» mban mbi shpatulla përgjegjësinë e përfaqësimit dinjitoz të krijimtarisë sonë të gjithanëshme letrare-artistike (me emrin e vet i kujton çdo shqiptari tre nëntorët e mëdhenj të historisë sonë kombëtare), asaj i takon të qëndrojë në një nivel sa më të lartë estetik-shkencor dhe, së fundi, duke qenë revistë letrare artistike shoqërore politike ajo duhet të zgjedhë nga moria e ngjarjeve, e fakteve dhe e veprimtarive të përmuajshme ato që pasqyrojnë drejt e saktë karakterin e jetës kulturore të shoqërisë sonë.

Të tria këto detyra themelore mendoj se revista jonë i plotëson me nder, me mençuri e pjekuri ideo-estetike.

Për krijuesin «Nëntori» është si një shtëpi e ngrohtë ku ai mbrin mbas shtegtimeve të gjata e të mundimshme të krijimit të veprës artistike.

Kur përfundoj një film artistik ose dokumentar pres të lexoj në mënyrë të veçantë se çfarë do të shkruajë për të revista «Nëntori». Vlerësimet dhe vërejtjet e saj janë për mua, e me sa kam vënë re edhe për kineastët e tjerë, një gjykim i saktë që të ndihmon në punën e mëtejshme krijuese. Ajo gjithmonë ka çmuar arritjet e kinematografisë sonë dhe

ka inkurajuar krijuesit e rinj që në filmat e tyre të parë, kur këta kanë qenë të nivelit të duhur ideoartistik.

Është e vështirë të mos ia pranosh revistës kërkesën për një artikull ose studim kritik, sepse ajo di të afrojë bashkëpunëtorët, të nxisë fantazinë e tyre dhe të përkujdeset seriozisht për ruajtjen e përfaqësimit dinjitoz të autorëve. Mbledhjet e kolegjumit të saj janë serioze e frytdhënëse dhe jo formale e të zgjatura, ndaj në to të gjithë shkojmë me qejf e të përgatitur.

Kujdesi i «Nëntorit» për traditën dhe kërkimet novatore, për pasqyrimin e përvojës krijuese dhe të jetës së vendit, për nivelin e kritikës dhe të veprave të letërsisë botërore, bëjnë që lexuesi në çdo numër të ketë çfarë të lexojë, çfarë të shijojë e çfarë të mendojë. Ja përse «Nëntori» është ndër revistat që lexohet e pëlqehet.

Edhe tani që filmin tonë e pasqyron më gjerësisht revista «Skena dhe ekrani» kineastët do të dëshironin që «Nëntori» të mos e humbasë traditën e mirë të ndjekjes hap pas hapi të zhvillimit të artit tonë kinematografik, por të vazhdojë të përkrahë e të frymëzojë krijuesit e tij të shumtë.

Viktor Gjika

ATY KU TROKASIM DHE NA PRESIN ME DASHURI

T'i urosh revistës «Nëntori» suksese të mëtejshme është një kënaqësi e veçantë, aq më tepër për poetët e prozatorët e rinj, të cilët kanë gjetur te kjo revistë dashurinë dhe kujdesin për talentet që vijnë, kritikun aq dashamirës dhe serioz.

Si organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, revista «Nëntori» ka ditur gjithmonë të zgjedhë mes krijimeve ato më të mirat, më të arrirat. Pikërisht për këtë arsye kjo revistë mbetet një organ i dashur, një orientues dhe bashkëpunëtor për krijuesit.

Ne krijuesit e rinj kemi trokitur gjithmonë në revistën «Nëntori». Fillimi i krijimtarisë ka dhe druaj-

tje, por «Nëntori» druajtjen na i ka zëvendësuar me besim në të ardhmen tonë, nxitimin rinor me një punë këmbëngulëse mbi vargun.

Nëse do të uronim revistën «Nëntori» me rastin e 30-vjetorit të saj, urimi ynë do të qe ky:

Qofsh gjithnjë dashamirëse e talenteve të reja, një shok i dashur e i afërt dhe një mësues i rreptë, që gjithmonë kujtohet me respekt nga nxënësit e tij!

Adelina Balashi Redaktorja.

NGJARJE E SHËNUAR JO VETËM PËR SHKRIMTARËT E ARTISTËT

Jubileu i revistës është një ngjarje e shënuar jo vetëm për shkrimtarët e artistët, për redaksinë dhe për kolegjiun, por edhe për ne si tipografë. Nga duart tona kalon çdo faqe e revistës. Dhe është një punë që e bëjmë me kënaqësi, se «Nëntori» ynë e mban gjithmonë lart emrin e muajit të madh të historisë sonë. Ne kemi fatin që, për hir të punës, të jemi lexuesit e parë të tij. Dhe na pëlqejnë krijimet letrare që botohen në revistë, na pëlqejnë shkrimet dhe artikujt për problemet e letërsisë dhe të arteve, monografitë dhe studimet nga tradita, shkrimet për njerëzit e shquar të penës e të pushkës, që aftësitë dhe talentin e tyre e vunë në shërbim të atdheut etj. Ja pse çdo numër i revistës pritet me interes, ja pse pyetjen: «kur del numri i ri i «Nëntorit»?» e dëgjojmë shpesh. E në këtë lidhje të ngushtë të revistës me masat e lexuesve dhe me shkrimtarët e artistët, kanë pjesë edhe tipografët. Jubileu i 30-të na vë edhe ne përpara detyrash më të mëdha, për ta shtypur revistën sa më të bukur, me nivel sa më të lartë, ashtu siç janë dhe lexuesit e saj të shumë.

Leida Lëvizshë Shkrimtarja

40 vjet letërsi dhe arte të realizmit socialist

STAVRI KRISTO

ROMANI YNË NË RRUGËN E ZHVILLIMIT TË PANDËRPRERË

Vështrim panoramik

1.

Vitet shtatëdhjetë, sidomos dhjetëvjeçari 1973-1983, shënuan suksese të reja për konsolidimin e mëtejshëm të romanit, si lloji që po paraprin në letërsinë tonë të realizmit socialist. Këtë përfundim e nxjerrim jo vetëm sepse gjatë këtij dhjetëvjeçari janë botuar afro 160 romane (nga 43 në periudhën 1959-1969) sepse, në fund të fundit, shifrat në letërsi s'përcaktojnë gjithmonë vlerën, por kryesisht nga vetitë e reja që ka fituar gjatë kësaj kohe proza e gjatë si në përmbajtje edhe në formë.

Në radhë të parë është pasuruar tradita e romanit për të pasqyruar më gjerë dhe më thellë historinë dhe jetën e popullit tonë, duke patur objekt pikërisht ato ngjarje që kanë sjellë ndryshime rrënjësore në strukturën e shoqërisë shqiptare sidomos Luftën Nacionalçlirimtare me ndodhitë e saj themelore, si: formimi i Partisë komuniste dhe përpjekjet e masave të gjera popullore që organizoi dhe udhëhoqi Partia në luftën kundër pushtuesve dhe tradhtarëve, në luftën e ashpër klasore, vendosjen e pushtetit të popullit, zhdukjen e shfrytëzimit të njeriut nga njeriu shndërrimet e mëdha në epokën e socializmit etj.

E dyta, në përputhje me vetë dinamikën e ngjarjeve të pasqyruara, në qendër të romaneve janë vënë e po vihen gjithmonë e më shumë forcat e reja të shoqërisë sonë, njerëzit që bënë luftën, punëtorët, fshatarët, intelektualët popullorë, ata që kanë kapërcyer dhe po kapërcejnë pengesat e vështirësitë dhe i kanë lënë e po i lënë kohës vulën e gjakut dhe të djersës së tyre, vulën e qëndresës, të heroizmit, të zgjuarsisë, të dëshirës për ta parë atdheun të lirë e të pavarur, të begatë.

E treta, ndërsa më parë binte në sy shpërpjesëtimi midis romaneve me temën aktuale dhe atyre me tema nga historia, në romanet e botuar gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit tema aktuale, sidomos ajo e ndërtimit socialist, ka zënë më shumë vend, problemet e kohës sonë janë trajtuar më gjerë, arenë e zhvillimit të ngjarjeve janë bërë qytetet e reja që i janë shtuar truallit tonë të lashtë në epokën e Partisë, veprat e mëdha të socializmit, kantieret e hidrocentraleve dhe të veprave të tjera të mëdha, fushat e gjera dhe kodrat e malet, ku po rrënjoset gjithmonë e më thellë socializmi.

Natyrisht, përfshirja për herë e më tepër e gjerësisë dhe larmisë së jetës, në mënyrë që dalngadalë të kompletohet tabloja e madhe e epokës socialiste në Shqipëri, mbetet detyrë bazë edhe e romancierëve tanë, por ajo që deshëm të nënvizojmë është fakti se data e botimit të romanit po bëhet gjithmonë e më e afërt me kohën e zhvillimit të ngjarjeve që pasqyrohen në të, duke hedhur poshtë ndonjë tezë e pikëpamje që ka lindur në botën borgjezo-revizioniste, ku s'janë të interesuar të pasqyrojnë aktualitetin në letërsi, si «teoria e distancës», pseudo-teori që s'për-

fillet nga krijuesit tanë. Afrimi i këtyre «dy datave» është vënë re sidomos këto tre-katër vjetët e fundit pas botimit të romaneve «Buka e një stine me borë», «Trëndafili në gotë», «Vëllezërit», «Një verë pa lamtumirë» etj. Kështu, Mühallaq Qilleri e titullon romanin e tij të dytë: «Në vitet e shtatëdhjetë», Betim Muço pasqyron në romanin e tij të parë ngjarje të vitit 1978, ndërsa Diana Çuli flet për ngjarje të vitit 1979. Po kështu veprojnë Xhaferr Martini në romanin «Sot dhe nesër», Alfred Kanini në romanin «Njeriu që dua», etj.

Një veçanti tjetër e romaneve më të mira të këtyre viteve është se kanë dalë para lexuesit si vepra më të plota, me subjekte të zhërvjellta, hera-herës shumëplanësh, ku gjithmonë e më me mjeshtëri janë lidhur më mirë fatet e njerëzve me ngjarjet më të rëndësishme kombëtare e shoqërore. Lidhur me këtë është për t'u nënvizuar fakti se vetë transformimet e mëdha ekonomiko-shoqërore që janë bërë në vendin tonë me përmasat, thellësinë, ritmet dhe dinamikën e tyre kanë pasuruar jo vetëm përmbajtjen ideore të romanit, por edhe mjetet artistike me të cilat është shprehur kjo përmbajtje e re, ato kanë lënë vulën e tyre edhe në strukturën e tij kompozicionale. Një shembull të mirë kanë dhënë sidomos romancierët më me përvojë, të cilët po krijojnë një traditë të pasur përse i përket vetë ndërtimit të romanit, traditë që po të studiohet me kujdes do të jetë mjaft e dobishme për të rinjtë që, me gjithë arritjet e mira në pasqyrimin e aktualitetit, dobësitë më të mëdha i kanë pikërisht në këtë fushë. Dritëro Agolli, për shembull, ka botuar deri tani disa romane, por secili prej tyre ka një ndërtim të vetin. «Komisari Memo» nuk u ngjan për nga struktura jo vetëm romaneve «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo» e «Trëndafili në gotë», por as «Njeriu me top», me të cilin ka përafërsi më të madhe tematikë dhe kohore. Romanet e këtij autori lexohen me kënaqësi, duke të lënë gjithmonë përshtypjen e mirë të harmonisë së një tërësie artistike origjinale. Kjo, natyrisht, vjen, në radhë të parë, sepse ky autor përpiqet të japë karaktere sa më të plota, duke i vënë ata në situata sa konkrete, aq edhe përgjithësuese, pra tipike, duke ndjekur hap pas hapi «fatin» e tyre, veprimet, mendimet, ndjenjat e tyre.

Përgjithësisht, në romanet e kësaj periudhe ka-

rakteret kanë qenë më të plota, më të thella, më të skalitura, janë zbuluar përpara lexuesit më shumë lidhje të individit me realitetin, janë shfrytëzuar më mirë mundësitë e llojit për t'i zbuluar karakteret në dinamikën e rritjes së tyre, se në asnjë lloj e gjini tjetër të letërsisë artistike nuk mund të zbulohet në mënyrë kaq të plotë, në gjerësi e thellësi, psikologjia e individit e ngritur deri në psikologji shtresash e klasash, si në roman. Shembuj të tillë të mirë, kur janë shfrytëzuar këto epësi gjejmë si në romanet historike («Skënderbeu», «Sos për mua a për ti...»), ashtu edhe në ata që pasqyrojnë Luftën («Njeriu me top», «Belxhiku që këndon vënçe» etj.) dhe në ato me temën e ndërtimit socialist («Një verë pa lamtumirë», «Pajtoni i fundit», «Buka e një stine me borë» dhe sidomos «Vdekja e zotit Kaloti» etj.).

Dhe kryesorja, gjatë këtij dhjetëvjetshi, përveç romanicerëve tanimë me përvojë, kanë botuar romanet e para e të dyta një varg tregimtarësh të rinj që po krijojnë plejadën e talentuar të romancierëve të viteve tetëdhjetë dhe të dekadave të ardhme.

2.

Po të kthejmë sytë andej nga fillimi i dekadës së kaluar, do të shikojmë se viti 1970 nga tetë romanet e botuara, na la vepra të tilla, si: «Komisari Memo» i Dritëro Agollit, «Përsëri në këmbë» i Dhimitër Xhuvanit, «Kështjella» i Ismail Kadaresë, «Një lindje e vështirë» i Elena Kadaresë etj., që secili veças dhe të gjithë së bashku, shënuan një ngjiturje të ndjeshme të romanit shqiptar për në etapën e pjekurisë dhe përsosjes së tij të mëtejshme. Pas dy vjetësh Dritëro Agolli do të botonte romanin e tij të dytë të shquar, shumë aktual e luftarak «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo», që tregon, veç të tjerash, aftësinë e shoqërisë sonë për të pastruar vazhdimisht skorjet dhe për të qëndruar kurdoherë e pastër, ndërsa Ismail Kadareja do t'i jepte lexuesit veprën e tij madhore «Dimri i madh». Në vitin 1974 Sterjo Spasseja botoi vëllimin e parë të ciklit «Rilindësit» — romanin «Zgjimi», i cili u ndoq në këtë dhjetëvjetsh nga «Pishtarët», «Ja vdekje ja liri» dhe «Kryengritësit», cikël ky që plotësoi një zbrazëti në pasqyrimin e luf-

tës dhe përpjekjeve të rilindësve tanë për liri, për pavarësi dhe për ruajtjen e tërësisë tokësore të atdheut tonë të lashtë dhe që është pritur me interes nga lexuesi. Një vit më vonë Sabri Godo, Skënder Drini dhe Teodor Laço shënuan një sukses tjetër për pasqyrimin në roman të tri etapave të ndryshme të historisë dhe të jetës së popullit tonë, duke botuar përkatësisht romanet «Skënderbeu», «Shembja e idhujve» dhe «Përballimi».

Po këtë vit Dritëro Agolli botoi romanin «Njeriu me top», Miço Kallamata «Shtigjeve të zëna», Ruzhdi Pulaha «Rruga Budi 732», Ali Abdihoxha «Dueli i madh», Vath Koreshi «Mars», Dhurata Bozdo «Shkëlqim i rremë» etj.

I mbarë ka qenë, sidomos, viti 1979, i cili i shtoi letërsisë sonë një varg romanesh me vlera të dukshme ideoartistike, si «Belxhiku që këndon vënçe» i veteranit të letërsisë sonë të realizmit socialist, Shevqet Musarajt, «Lulja e kripës» e Jakov Xoxës dhe «Këshilltarët» i Fatmir Gjatës. Ky vit plotësoi edhe një mangësi që ishte vënë re në tematikën e romanit tonë: romanet «Buka e një stine me borë» i Koço Kostës, «Luginat» i Hasan Petrelës, «Një verë pa lamtumirë» e Zija Çelës dhanë, secili në mënyrën e tij, transformimet e mëdha ekonomike, shoqërore dhe psikologjike që kishin ndodhur në fshatin tonë socialist deri në atë kohë, duke na paraqitur me nivel artistik freskinë e jetës gëzimin e punës dhe një galeri të tërë tipesh. Po këtë vit, duke vazhduar lëvrimin e temës historike, romancieri Sulejman Krasniqi, pas romaneve «Qielli i përflakur» (1974), «Prijësja e komitëve» (1975) etj., shpalosi me afsh e dashuri përpara lexuesit jetën dhe veprën legjendare të Mic Sokolit, ndërsa Nasho Jorgaqi botoi «Mërgatën e qyqeve», i cili vazhdon të mbetet një nga romanet më të gjerë e më të plotë në llojin e vet.

Përveç romancierëve që përmendëm, gjatë kësaj periudhe kanë dhënë ndihmesën e tyre në zhvillimin e këtij lloji të gjinisë së prozës edhe romancierët Agim Gjakova me romanet «Në kërkim të së vërtetës» (1976) e sidomos me «Dritëhijet e një qyteti» (1983); Ali Abdihoxha, pas «Dueli i madh» (1975), me «Vila në periferi» (1982), etj. Anastas Kondo, Agim Cerga, Kolë Jakova, Kiço Blushi, Ferhat Cakaj, Natasha Lako, Eg-lantina Mandia, Nasi Lera, Neshat Tozaj, Alfred Ka-

nini etj. kanë botuar gjithashtu romane që janë mirëpritur nga lexuesi i gjerë.

Ja kështu, vit pas viti romani ynë vazhdon të krijojë një traditë të pasur, jo vetëm duke trajtuar disa tema kyçe të historisë së lavdishme të popullit tonë dhe të Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe në pasqyrimin gjithmonë e më mirë të realitetit të sotëm të shoqërisë socialiste, temë e cila po zë kryen e vendit. Është pozitiv fakti që këtë temë po e trajtojnë kryesisht romancierët e rinj dhe, natyrisht, ata po kapërcejnë e do të kapërcejnë edhe vështirësitë e rritjes, por edhe veprat e tyre të para e të dyta janë një dëshmi që premtan se romani ynë, në vazhden e traditave më të mira, do të ngrihet në një nivel të ri cilësor.

3.

Është fakt i njohur se çdo letërsi vlerat e veta të vërteta i ka treguar duke pasqyruar realitetin e kohës. Nga ky rregull s'ka si të bëjë përjashtim edhe romani ynë, por edhe pasqyrimi i së kaluarës ka qenë gjatë kësaj kohe detyra e romanit si e gjithë lehtësisë, sepse edhe evokimi i historisë, si shumë detyra të tjera, për shkaqe që dihen, mbeti pa u kryer nga romani në kohën e vet. Me përjashtim të dy-tre romaneve, ne s'trashëguam nga e kaluara pothuajse asgjë në këtë fushë. Ndryshe ka ndodhur për shembull në poezi. Po nuk është as rasti i parë dhe as i fundit ky që revolucionin ynë socialist zgjidh edhe detyra të revolucioneve shoqërore paraardhëse, sepse vendi ynë ka qenë i pushtuar për një kohë të gjatë dhe në periudhën e Pavarësisë kombëtare mbizotëroi obskurantizmi mesjetar. Pasqyrimi i luftërave dhe i përpjekjeve të stërgjyshërve tanë i shërben rritjes së atdhedashurisë, rritjes së krenarisë për traditat patriotike dhe revolucionare.

Na duket e udhës të nënvizojmë se pikërisht gjatë këtij dhjetëvjetëshi, veç veprave të shkrimtarëve që përmendëm, zunë vendin e tyre të merituar edhe romanet historike, si ai i Miço Kallamatës «Sos për mua a për ti...» (1978), i Ferhat Cakajt «Zemërimi» (1980), i Skënder Drinit «Vraje tradhëtinë» (1980), i Vito Koçit «Qëndresa» (1982) etj. Një sukses i ndje-

shëm i shënuar nga romani historik gjatë kësaj periudhe është sidomos shtrirja më e gjerë në historinë e popullit tonë. Në të kaluarën, dhe në vitet e para të këtij dhjetëvjetëshi pothuajse të gjitha romanet historike («Kali i Skënderbeut», «Kalorësi i Skënderbeut», «Skënderbeu», «Kështjella») i kushtoheshin Heroit tonë Kombëtar dhe luftërave të tij legjendare, qëndresës së shqiptarëve në kohën e tij. Romanet historike të botuara më vonë trajtojnë shumë nga momentet kyçe të historisë së popullit tonë, si duke u futur thellë në lashtësi, në kryengritjet e mëvonshme kundër Tanzimatit, në epokën e Rilindjes sonë kombëtare, deri në periudhat e mëvonshme.

Në romanet historike të viteve të fundit, pavarësisht se në analizën konkrete të secilit prej tyre kritika ka vërejtur edhe mangësi, historia jonë në përgjithësi është pasqyruar drejt dhe niveli i tyre artistik ka qenë i mirë. Nepërmjet subjekteve tërheqëse e të goditura dhe karaktereve në tërësi të skalitura, këto romane kanë treguar në radhë të parë se populli ynë ka luftuar i vetëm kundër armiqve të egër e barbarë dhe ka fituar, sepse gjithmonë ka vënë nderin, lirinë, tërësinë tokësore të atdheut mbi jetën, mbi mallin e gjënë. Kjo ide spikat sidomos në gjithë ciklin «Rilindësit» të Sterjo Spases, në romanet e Jonuz Dinit, në «Mic Sokoli» të S. Krasniqit, në «Sos për mua a për ti...» të Miço Kallamatës, në «Vraje tradhëtinë» të Skënder Drinit, në «Zemërimi» të Ferhat Cakajt, në «Një atentat në Paris» të S. Këlliqit, si dhe në «Dritëhijet e një qyteti» të Agim Gjakovës dhe në «Vila në periferi» të Ali Abdihozhës, të cilat edhe pse s'janë romane të mirëfillta historike, evokojnë të kaluarën.

Në to është pasqyruar më së miri lufta dhe përpjekjet e fshatarësisë punonjëse, e zejtarëve, e shtresave të vegjëlisë në përgjithësi dhe janë stigmatizuar, shtypësit, shfrytëzuesit, duke treguar në këtë rast të vërtetën e madhe se pushtuesit s'do ta përballonin dot kurrë luftën e popullit tonë pa ndihmën e klasave shfrytëzuese, sidomos të bejlerëve dhe të agallarëve, ashtu si dhe këta të fundit s'do ta mbanin dot kurrë popullin në shtypje e shfrytëzim pa pralinë e pushtuesve. Vatra të ndezura të luftës për liri (ashtu siç ishin) tregohen në këto romane shtëpitë e zejtarëve, stanet e barinjve dhe kasollet e fshatarëve.

Nga faqet e historisë janë ngjitur me dinjitet në galerinë e heronjve të romanit tonë historik jo vetëm Skënderbeu, por edhe Rapo Hekali, Mic Sokoli, Shote e Azem Galica, Ded Gjo Luli, Ismail Qemali, Themistokli Gërmenji, ashtu siç janë krijuar mbi bazën e një materiali të pasur jetësor figurat realiste të Marin Haxhivasilit, Braho Shkrelit, Dan Delisë, Zenel Gjokës, Bestar Kosovës, Luli Bardhit, Mentar Dikës dhe heronjve e personazheve të tjera të romaneve historike të këtij dhjetëvjetëshi.

Tingëllimi i qartë aktual ka qenë një veçanti tjetër që u ka shtuar vlerat edukuese romaneve historike.

Por, me gjithë arritjet e dukshme, në romanin tonë historik ka ende mangësi që duhen vënë në dukje. Së pari, edhe pse romani historik është futur thellë në lashtësi dhe ka ardhur gjer në periudhën e pavarësisë, duke kapërcyer mangësinë e shtrirjes në kohë, prapë vihet re një farë njëanshmërie në pasqyrimin e realitetit shqiptar. Ku e shohim këtë? Dihet e vërteta e madhe se populli ynë ka luftuar, «e ka çarë rrugën e historisë me shtatë në dorë», dhe kjo e vërtetë është pasqyruar mirë në të gjitha romanet historike. Lufta, qëndresa, përpjekjet me armë, kryengritjet, zënë kryet e vendit pothuajse në çdo roman. Ky është një realitet dhe s'ka sesi të mos pasqyrohet në radhë të parë e mbi çdo gjë. Por edhe kërkon që të zgjerohet gama e pasqyrimin të jetës, të rroken aspekte të reja të luftës dhe të përpjekjeve të masave popullore për liri, për bukë, për tokë e përparim shoqëror. Populli ynë e ka mbrojtur atdheun me armë dhe me gjak. Në kohën midis luftërave dhe kryengritjeve, në prapavijë, në periudhat relativisht «të qeta», ai ka bërë jetën e vet aktive. Se, në fund të fundit, gjithë ky gjak është derdhur «me okë» për të mbrojtur tokën e mbrojtur me të, nderin, jetën e lirë, por edhe djersën dhe frytet e saj, të cilat presin të bëhen lëndë e romaneve tona. Veç kësaj, edhe një çështje tjetër, që mendoj se duhet ta mbajnë mirë parasysh ata që evokojnë artistikisht historinë në prozën e gjatë: herë-herë në këto romane vihen re përshkrime jashtëletrare, herë-herë ndonjë qëndrim emfatik dhe pak më shpesh një zgjatje e panevojshme, ku përshkrimi i ngjarjeve kthehet në qëllim në vetvete dhe nuk është në funksion të karakterizimit

dhe të tipizimit të personazheve ose të atmosferës e të rrethanave, produkt i të cilave janë bëmat, mendimet dhe veprimet e tyre. Nga kjo, si dhe nga ndonjë hallakatje e linjave të subjektit dhe ndonjë cenim i kompaktësisë së strukturës kompozicionale, nuk kanë shpëtuar as disa nga romanet tona më të mira.

4.

Lufta Nacionalçlirimtare mbeti një minierë e pashtershme temash e subjektesh dhe një zjarr e passhuar frymëzimi për shkrimtarët tanë edhe gjatë dhjetëvjetëshit së fundit. Dhe s'ka sesi të ndodhë ndryshe: te përpjekjet e popullit të organizuar e të drejtuar nga Partia Komuniste në këtë luftë, te gjaku i 28 mijë yjeve të pashuara, e kanë themelin të gjitha fitoret tona, ndaj për ne tema e Luftës mbetet gjithmonë aktuale.

Që nga viti 1973 deri në ditët tona janë botuar 28 romane që pasqyrojnë aspekte të ndryshme nga kjo epope e lavdishme e popullit tonë, e organizuar dhe e udhëhequr nga Partia me shokun Enver Hoxha në krye.

Në veprat më të mira të këtij dhjetëvjetëshi, si në «Komisari Memo» (1970), «Kronikë në gur» (1971), «Njeriu me top» (1975), «Shtigje të zëna», «Zgjimi i Nebi Surelit» dhe «Nëntori i një kryeqyteti» (po të 1975), «Kur malet kërkonin diellin» (1976), «Prova e zjarrit» dhe «Yje e helmeta» (1977), «Këshilltarët» dhe «Belxhiku që këndon vende» (1979), «Lulja e kripës» (1980-1981) etj, është pasqyruar me vërtetësi koha e luftës në disa nga momentet e saj më të qenësishme.

Të bie në sy, në radhë të parë, pasqyrimi i përpjekjeve të komunistëve shqiptarë për të bashkuar të gjitha shtresat dhe klasat në Frontin Nacionalçlirimtar, për t'i hedhur ato në luftë kundër okupatorëve dhe tradhtarëve, duke dhënë vetë të parët shembullin e guximit dhe të sakrificës. Komisari Memo Kovaçi i romanit me të njëjtin titull të Dritëro Agollit, ashtu si dhe komunisti fshatar Murat Shtaga i «Njeriut me top», komisar Belxhiku i «Belxhikut që këndon vende», Behar Jata të «Këshilltarët» si dhe Petriti në romanin «Lulja e kripës» etj. përpiqen, secili sipas mënyrës së vet dhe sipas kushteve ku zhvillohen

ngjarjet, të mobilizojnë popullin në luftën për liri, për pavarësi e drejtësi shoqërore. Ata paraqiten si veprimtarë luftëtarë që s'marrin parasysh asnjë rrezik e vështirësi. Spikatin në këto romane sidomos përpjekjet e komunistëve për ta lidhur fshatarësinë me luftën e klasës punëtore, nga njëra anë, si dhe përpjekjet e vetë fshatarëve, nga ana tjetër, për t'i lidhur aspiratat, përpjekjet dhe luftën për liri dhe tokë me çështjen e vërtetë të komunistëve, me programin e Partisë, ku gjetën rrugën e vetme jo vetëm për çlirimin e kombit të robëruar, por edhe për të mbrojtur interesat e tyre themelore klasore. Fshatarësia punonjëse jepet në këto romane ashtu siç ishte me të vërtetë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, si baza më e gjerë e Frontit, si forca kryesore goditëse në kryengritjen e përgjithshme të armatosur, si mbështetje e madhe e pushtetit të ri të lindur në luftë.

Në disa romane kjo veprimtari e gjerë e komunistëve shtrihet edhe me shtresat e tjera, si, bie fjala, në inteligjencien përparimtare të qytetit etj. Përpjekjet e Memo Kovaçit me shokë për ta lidhur familjen e Doktor Kristo Borovës me luftën e të gjithë popullit pasohen nga përpjekjet e Belxhikut, të Petritit, etj. për të përfshirë në Front të gjitha klasat dhe shtresat që ishin kundër pushtuesit dhe tradhtarëve. Është pasqyruar kështu edhe ai diferencim klasor që u bë në gjirin e shoqërisë shqiptare të kohës. Tablo të qarta të këtij diferencimi jepen në të gjitha romanet e përmendura, por spikatin më me forcë në romanet «Komisari Memo», «Njeriu me top», «Belxhiku që këndon vëç», «Këshilltarët», «Midis dy kohëve» etj. Dalin në pah me këtë rast disa veçanti të reja, me të cilat është pasuruar romani që pasqyron Luftën Nacionalçlirimtare të popullit tonë.

Një problem tjetër që pasqyrojnë romanet me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare, të botuara në këtë dhjetëvjetësh, është ai i shkatërrimit të godinës së regjimit të vjetër të pushtuesve dhe të klasave shfrytëzuese dhe i ngritjes e ndërtimit të pushtetit të ri të Këshillave Nacionalçlirimtarë. Kështu, në romanin «Këshilltarët», siç duket edhe nga vetë titulli, kryen e vendit e zë veprimtaria luftarake e këshillit të fshatit Maliskajë dhe sidomos e kryetarit të tij, fshatarit atdhetar Murat Bença, veprimtari që përgjithëson në roman historinë e vendosjes së pushtetit popullor në

fshat, dhe jo vetëm në fshat, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Duke u bërë diferencime të thella revolucionare në vetë strukturën klasore të shoqërisë, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare u zhvilluan më tej traditat më të mira të popullit tonë, ato u kalitën, si të thuash, në zjarrin e kësaj lufte dhe fituan cilësi krejt të reja, si në planin botëkuptimor, ashtu edhe në atë moral, — fakt jetësor që ka gjetur gjithashtu mishërimin e tij artistik në romanin e këtyre viteve. Vetë bashkimi i popullit në Frontin Nacionalçlirimtar, nën udhëheqjen e Partisë, hodhi bazat e një uniteti të ri, e një patriotizmi të ri, e një etlike të re me rrënjë të shëndosha klasore revolucionare.

Këtë e kishin treguar shqiptarët në çdo luftë dhe kundër çdo pushtuesi. Meritë e Partisë është që u dha këtyre virtyteve të trashëguara përmbytje të theksuar klasore. «Ideologjia e Partisë, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — u mpleks fort me të gjitha virtytet e lavdishme të popullit tonë. Fara e mirë ra në një terren bujar dhe mbiu e shëndetshme». Ky aliazh ideor, moral e ndijor, u duk në radhë të parë të vetë komunistët.

Veçanti e romaneve për Luftën Nacionalçlirimtare është se pasqyrojnë pikërisht më gjerë e më thellë këto koncepte të reja për atdheun, për shoqërinë, detyrat ndaj saj. Fjala «shok» në gojën e personazheve të këtyre romaneve merr një përmbytje të re, të bazuar në interesat klasorë, në interesat e lartë të revolucionit. Forca të mëdha njerëzore u çliruan nga ky transformim ideologjik që filloi të bëhej jo vetëm në pjesëmarrësit e formacioneve të organizuara, por në mbarë popullin, në fshatarësinë, në rininë, te gruaja. Mjafton të kujtojmë rritjen shpirtërore të Sino Borakës nën ndikimin e atmosferës luftarake që përshkruhet me aq besnikëri në romanin «Belxhiku që këndon vëç», ripërtëritjen e Nebi Syrelit, ose edhe vetëm debatet e Komisarit Memo me Rrapo Tabanin për pranimin e shoqeve në batalionin partizan për t'u bindur se, që në ato vite, u hodh mbi truallin e virtytit shqiptar fara e revolucionit ideologjik e kulturor, e përpjekjeve për emancipimin e gruas, e luftës kundër paragjykimeve dhe prapambetjes etj. Të gjitha këto shtojnë jo vetëm vlerën

njohëse të këtyre romaneve, por edhe vlerën edukuese.

Trajtimi i një problematike më të gjerë e më të ngrohtë, thellimi në ato ndryshime qenësore që solli Lufta në strukturën klasore në moralin, në psikologjinë e në jetën e popullit, s'ka asnjë dyshim se është shoqëruar në romanet më të mira me një rritje të mëtejshme të mjeshhtërisë artistike, megjithëse me të drejtë është vënë re se në disa romane, që pasqyrojnë këtë periudhë ka të meta e mangësi, si zbehtësi dhe skematizëm në paraqitjen e ndonjë heroi pozitiv, rendje pas përshkrimit të veprimeve, karakter memorial, mungesë materiali të ri dhe të pasur për dhënien e disa karaktereve, ndonjë përsëritje situatash, herë-herë ka zgjatje apo dialog agjitativ etj.

5.

Zhvillimi i mëtejshëm i romanit është i lidhur me pasqyrimin më të gjerë dhe më të thellë të realitetit tonë socialist. Kjo kërkon përvetësimin e përvojës së deritanishme dhe pasurimin e vazhdueshëm të saj. Problemet e mjeshhtërisë artistike shfrytëzimi i mundësive të llojit dhe pasurimi i tyre me përvojë të re kanë dalë në plan të parë. Mundësitë që jep romani si lloj janë të pakufishme, qoftë për të krijuar tablo të gjera artistike, qoftë për të dhënë karaktere të plota të njerëzve tanë, si tërësi marrëdhëniesh shoqërore.

Është mirë që datat e botimit të romanit dhe e ngjarjeve që pasqyrohen në të të jenë sa më të afërta. Por kjo, ama, s'duhet t'i shtyjë në asnjë mënyrë romancierët që të lënë pas dore sadopak kërkesat e llojit, të bien në publicistikë dhe, për rrjedhojë, faqe të tëra të «veprës» së tyre t'i zënë përshkrimet gazetareske ose të kthehen romanet në grumbull mozaik ngjarjesh, përshtypjesh ose mbresash — e metë dhe mangësi që po nxjerr krye edhe në ndonjë roman të botuar vitet e fundit. Kanë vlerat e tyre dy romanet me temën e ditës të Sulejman Krasniqit, që janë botuar në këta pesë-gjashtë vjetët e fundit: «Beteja të nëndheshme» (1977) dhe «Lindita» (1978), ashtu siç ka vlerat e veta edhe romani «Ditë që vështrojnë larg» i Betim Muços dhe ndonjë tjetër, megjithatë, kur i mbaron së lexuari, ca nga personazhet e tyre

s'të mbeten të gjithë shokë e miq, të kujtohen veçse disa ngjarje, disa batuta të goditura, cazë humor i lehtë dhe ndonjë skenë a dialog «i fortë». Njerëzit e shumë, që lëvizin dhe zëvendësojnë njëri-tjetrin nëpër faqet e këtyre romaneve, i shikon nga larg ose, në rastet më të mira, të duket sikur i ke patur një ditë pushimi fqinjë, në tavolinën pranë të një bar-lulishteje. Pse ndodh kjo? Në referatin që mbajti shoku Dritëro Agolli në Plenumin e Lindjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, në prill të vitit 1982, ndër të tjera tha: «Nuk janë të gjitha anët e jetës së njeriut njëlloj të rëndësishme dhe njëlloj kurioze për t'u pasqyruar. Njeriu në jetën e tij ka shumë gjëra e shumë veprime... Ajo që është e përparuar te njeriu, ajo që është e re dhe e rëndësishme në karakterin e tij dhe në personalitetin e tij, kjo influencon edhe në gjithë veprimet e tij. Këtë duhet ta zbulojë artisti, se kjo merr forcë edukuese.»

Nuk është treguar gjithmonë kujdes prej artisti në seleksionimin e materialit jetësor dhe në ngjizjen e tij me trillim krijues. Nuk janë kërkuar dhe gjetur gjithmonë mjetet shprehëse më të përshtatshme dhe më të bukura të përmbajtjes, duke filluar që nga subjekti i zhërvjellët, kompozicioni, vendosja e personazheve në rrethana tipike për të shfaqur karakterin dhe individualitetin e tyre, nga përshkrimi i peizazhit deri te portretizimi fizik dhe moral i heronjve dhe i personazheve. Nuk bëhet gjithmonë përpjekje për të hyrë thellë në botën e brendshme të personazheve, për ta bërë njeriun tonë të ri objekt kërkimor të letërsisë, për të zbuluar sidomos ato veti e virtyte që kanë lindur e lindin përditë. Realiteti ynë socialist tregon se personaliteti, vetitë individuale, jo vetëm që nuk zhduken, nuk shkrihen në të tërën, siç shpëifin apologjetët borgjezë dhe revizionistë, duke tundur si flamur fakti ndonjë roman skematik, por përkundrazi krijohen kushte gjithmonë e më të mira për përsosjen e figurës morale-politike të njeriut, për përsosjen fizike dhe shpirtërore të tij.

Pa mohuar vlerat e tyre, qoftë edhe relative, kritika dhe lexuesi kanë kërkuar më shumë, pikërisht në këto drejtime, nga disa romane të botuara në këtë dhjetëvjetësh, si «Sekreti i gjelbër», «Drizana», «Nën harqet e zjarrta», «Një shenjë e veçantë», «Jeta dhe motrat e saj» etj.

Është dhe kjo një nga arsyet që e shtyjnë lexuesin të mos kënaqet ndonjëherë nga romanet e botuara dhjetë vjetët e fundit. Ndaj edhe Kongresi i tetë i PPSH theksoi që në këtë stad të zhvillimit që ka hyrë vendi ynë «përmbajtjes së shëndoshë, tematikës revolucionare t'u përgjigjet një formë dhe një nivel i lartë realizimi artistik.»

Një bazë e shëndoshë për të kapërcyer të metat dhe mangësitë e deritanishme është vetë përvoja dhe tradita që ka krijuar romani ynë në pasqyrimin e realitetit socialist, duke filluar nga «Dimri i madh» i Ismail Kadaresë, që trajton një periudhë të rëndësishme të historisë bashkëkohore, të luftës kundër revizionizmit hrushovian, nga «Buka e një stine me borë», ku pasqyrohet me vërtetësi njeriu i thjeshtë i punës me moral të lartë dhe deri te romanet e muajve të fundit, si: «Zëri i largët» i Diana Çulit ose «Dora e ngrohtë» e Neshat Tozajt, që shtrojnë e zgjidhin në faqet e tyre me guxim e origjinalitet, probleme të mprehta të shoqërisë sonë dhe hyjnë si armë të efektshme në fushat e betejave të revolucionit ideologjik e kulturor, të luftës së klasave që po zhvillohet me sukses në vendin tonë. Se ka patur dhe raste kur problemet e mprehta janë hedhur, por janë lënë në mes të rrugës, nuk janë çuar konfliktet gjer në fund, «është spostuar pika e gravitetit nga kryesorja në të zakonshmen». Po edhe mbetja brenda suazës së një «problemi» të lehtë sjell zbehtësinë e ktij, i ngushton frymëmarrjen romanit, nuk i shfrytëzon sa duhet mundësitë e llojit, sidomos kur ky problem mbetet brenda caqeve të intimes. Njeriu është një kompleks i tërë marrëdhëniesh shoqërore dhe ndarja prej tyre, prerja e fijeve që e lidhin me kolektivin, me jetën e gjerë të shoqërisë, do ta varfëronte shumë figurën e tij. Një karakter letrar i tillë s'do të ishte kurrë i plotë për një roman. Është mirëpritur, për shembull, romani i ri i Elena Kadaresë «Bashkëshortët» për subjektin e tij të zhdërvjellët edhe për problemet intime familjare që ngre. Ingranimi i dy njerëzve të rritur në mjedise të ndryshme, në jetën e një familjeje nxjerr probleme. Megjithatë lexuesi me të drejtë ka kërkuar që frymëmarrja e romanit të ishte më e gjerë, të lidhej edhe me probleme të tjera shoqërore. Gruaja e ditëve tona nuk mund të jetë kurrë e emancipuar në familje, në marrëdhëniet fa-

miljare, pa qenë një pjesëmarrëse vepruese e jetës shoqërore. Për të kuptuar se sa të domosdoshme janë kërkesat për ta dhënë personazhin sa më të lidhur me jetën shoqërore, le të krahasojmë secilin nga heronjtë dhe personazhet e romaneve që përmendëm më lart me Zejnulla Kalotin e romanit të Dhimitër Xhuvanit, që mbetet një nga personazhet e rrallë të romaneve të viteve të fundit, psikologjia e të cilit është zberthyer me mjeshtri, duke shfrytëzuar mirë mundësitë funksionale të llojit. Ky romancier me përvojë ka kapur atë që është qenësore në botëkuptimin, në ndjenjat, në psikologjinë e gjithë shtresës nga vjen Zejnulla Kaloti, pa lënë pas dore dhe ato detaje që plotësojnë kuadrin, të cilat përbëjnë sfondin. Prandaj edhe tërë figura ka dalë e plotë, e gjallë dhe konflikti i besueshëm. E rëndësishme është se shkrimtari e ka përcaktuar qartë qëndrimin e vet. Psikologjia mikroborgjeze është objekt lufte të vazhdueshme në shoqërinë tonë. Lufta kundër saj ka rëndësi për vetë shtrirjen e kësaj psikologjie, sidomos po të kemi parasysh se dhe një pjesë e mirë e klasës punëtore, klasës më të përparuar të vendit, ka prejardhje zejtare e fshatare. Pasqyrimi i kësaj lufte realisht, si një domosdoshmëri historike, i shton shumë vlerat edukuese artistike të romanit.

Forcat e reja në roman i perfaqëson Ritvani, Reti etj. Është për të ardhur keq që, nga pikëpamja e zbulimit artistik të botës së brendshme, të zberthimit psikologjik të tyre, kundërshtarët s'janë «të një peshe». Ritvani dhe forcat e tjera të reja dalin ku e ku më të zbehta artistikisht se sa Zejnullai. «Klima» e tyre është dhënë ku e ku më e «valkët» sesa ajo që rriti dhe mbajti gjallë Zejnulla Kalotin. Ja, këtu shkrimtari s'ka arritur të kapë si dhe sa duhet te Ritvani, te Reti etj., gjithçka që është e re dhe e rëndësishme, ashtu siç i ka kapur, për shembull, te Din Hyka në romanin «Përsëri në këmbë», ose te Nebi Syreli. Po dhe në ndonjë roman tjetër të viteve të fundit vëmë re se personazhet «negative» janë më të realizuara artistikisht se mbartësit e së resë.

Pse ndodh kjo? Mund të ketë shumë shkaqe, por njëri prej tyre më duket se është fakti që në romanet për aktualitetin socialist ende s'ka zënë vendin e merituar, si tërësi marrëdhëniesh shoqërore përfaqësuesi tipik i klasës punëtore heqjemone në shoqë-

rinë tonë, si një njeri që prodhon të mirat materiale shijon kënaqësinë dhe gëzimin e punës së lirë krijuese, që në të njëjtën kohë i jep tonin gjithë jetës së vendit, shqetësohet për të gjitha problemet shtetërore e shoqërore, ushtron kontrollin e vet, nën udhëheqjen e Partisë së vet, mbi këdo e kudo.

Sepse këta heronj të jetës nuk po ngjiten në galerinë e heronjve të romaneve ashtu siç janë: njerëz me botëkuptim të shëndoshë, politikisht të qartë, me interesa të gjerë, familjarë dhe veprimtarë të mirë shoqërorë, me nivel arsimor e kulturor të lartë, mjeshtër të vërtetë, të apasionuar pas shkencës dhe teknikës, të dashur në kolektiv, udhëheqës të vërtetë shpirtërorë, që gëzojnë respektin dhe dashurinë e të tjerëve, që luftojnë për të çuar jetën më përpara, për të zhdukur çdo pengesë e vështirësi, çdo mbeturinë të së kaluarës në veten e tyre dhe të tjerët.

Pra, me gjithë sukseset e arritura, shumë thesare të jetës sonë socialiste s'janë hapur e shpalosur ende sa e si duhet në faqet e romaneve tona. Presim të ngjiten në galerinë e personazheve të romanit heronj-të e jetës, paçka se punojnë në kabinetet shkencore, ku projektohen veprat e mëdha ose në kantieret ku zbatohen ato projekte, në pusët e naftës ose në repartet e tezgjahut. Ata me siguri do t'i zbërthejnë kornizat e kufizimeve, skematizmin, shabllonet, cektësinë e mendimit... Ata do të sjellin origjinalitet dhe novatorizëm. Se «origjinaliteti dhe novatorizmi, — tha shoku Ramiz Alia në fjalën e tij «Rritja e cilësisë — detyrë themelore e letërsisë dhe arteve», — nuk qëndrojnë në komplikimin e subjekteve ose në trashjen e ngjyrave të ndezura, as në përdorimin e simboleve të kërkuara. Origjinaliteti qëndron në informacionin e ri që sjell vepra, në mesazhin e saj filozofik, në këndin e ri të shikimit të dukurive jetësore, në zbulimin e raporteve të reja shoqërore njerëzore».

Pikërisht këtë tregojnë edhe romanet më të mira të botuara vitet e fundit.

ISUF NELAJ

POEZI E KOHËS SË MADHE

«Frymëzime na dha koha e Partisë» —
antologji me poezi të zgjedhura

Një antologji dyqindfaqëshe me këngë popullore dhe me vjersha e fragmente poemash të 40 poetëve përfaqëson një pjesë të vogël të gjithë atyre këngëve e poezive kushtuar kohës së madhe të Partisë, që ka qenë dhe është burim i pashtershëm frymëzimi për poetët. Ishte Partia që hapi një epokë të re, hapi perspektiva të shkëlqyera për popullin tonë, i cili «vrite, prite për flamur», për të cilin vetëm me lindjen e Partisë «lindi dita e re», që rreze kudo çon. Vetëm atëherë, siç thotë kënga, kur «Enver Hoxha në Tiranë/ e formoi Partinë nënë» populli gjeti rrugën e vërtetë të çlirimit nga shtypja e shfrytëzimi, u ngrit me «djemt e vajzat si nure,/ me dyfek me saka-ture», përzuri armiqtë dhe fitoi lirinë: vetëm nën